Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ekspert Shqyrtues, Agim SHEQIRI Nënshkrimi_____	Data e autorizimit të ekspertit 19.04.2022	Data e dorëzimit të raportit 04.05.2022	Nr. i lëndës: 106/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.04.2022 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka pranuar ankesën me nr. prot.106 /22 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "ER-LIS"SH.P.K", lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne Komunën e Lipjanit** nr. ref. 613-635-221 i realizuar nga Komuna e Lipjanit

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë për të hapur, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 € kontratë kornizë tri vjeçare me një Operator Ekonomik.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMOR SIPAS OE ANKUES

ta

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Neni 56.15 I RRUOPP me sqarime te KRPP Pyetja 85

Pas njoftimit mbi Vendimin e AK dt.29.03.2022 për eliminim me arsyetimin se:

1. Nuk keni referenca të mjaftueshme
2. Mungojnë dëshmitë për pajisje si grupi I OE fitues në këtë rast, duke u bazuar në faktet e gjetura si më lartë.
3. Sa i përket pikes se pare ju njoftoj se kemi referenca të mjaftueshtme të punëve të kryera në sinjalizimin horizontal ,vertikal si dhe punë të ngjashme me shumë se Ju keni kerkuar për ketë projekt.
4. Për makineri Ju kërkoj që të formoni komision për verifikimin e makinerisë edhe pse kemi dorezuar të gjitha kërkesat e kerkuara në DT për pajisje teknike dhe profesionale, po ashtu edhe *"Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët*

Ne DT është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

)Autorizimin origjinal të prodhuesit (apo distributorit të autorizuar) për çdo produkt që përdoret për sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Certifikata nga prodhuesi për atestet e ngjyrave,llamarinës, folijes dhe shtyllave të zinkimit lexueshëm- kopje

Duke analizuar Ofertat e OE e posaqërishte të OE të propozuar për Kontratë kam vërejt se Komisioni vlerësues në kundërshtim me LPP-në ka bëre shkelje të **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**, Duke mos trajtuar te gjithë OE njësoj apo duke neglizhuar dhe duke bere lëshime te ndryshme tek kërkesat e Dosjes se tenderit: Psh disa OE te cilët nuk kane dorëzuar: ***Autorizimin origjinal të prodhuesit (apo distributorit të autorizuar) për çdo produkt që përdoret për sinjalizim horizontal dhe vertikal*** pastaj, OE të cilët nuk kanë dorëzuar Deklaratën nën Betim (ne qasje nuk është ngarkuar), ka OE të cilët kanë marrëveshje për makineri të cekur për këtë projekt disa tjerë nuk kane por janë trajtuar njëjte . Disa Operator kanë Atestet e vitit 2016 apo autorizimet e vitit 2018 etj etj E gjitha kjo në kundërshtim **me *Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.***

Kurse duke analizuar Çmimet e Operatoreve Ekonomik, Komisioni vlerësues edhe nëse nuk jan të lamisë adekuate *(nuk më është lejuar qasja ne Raportin e Komisionit)* në kundershtim me **Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët** kane bere shkelje të rënda duke u vu ne lajthitje për Çmimet JO-NORMALISHTE të ulëta sa ju përket materialeve te cilat janë rritur deri ne 300% muajve te fundit psh Hekuri etj.

Ne Përgjigjen e AK lidhur me pretendimet e Kërkesës për Rishqyrtim, AK ka sqaruar citoj:

Sa I përket Çmimit jo normalishtë të ulët, sipas legjislacionit në fuqi të Prokurimit Publik, te tenderët me Çmim të peshuar nuk aplikohet tenderi jo normalishte I ulëtNë rast të Çmimit më të ulët, duke peshuar Çmimet,Çmimet e peshuara bazohen në Çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar Çmimet e ofertuesve të ndryshëm.

E gjitha kjo në Kundërshtim në kundërshtim me Neni 56.15 I RRUOPP dhe sqarime te KRPP Pyetja 85 dt 6.06.2021

KRITERET PËR VLERËSIM

Çmimi me i ulet i poentuar /peshuar

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues OE ankues e kualifikon si të papërgjegjshëm me arsyetimin se:

- I mungojnë referencat
- I mungojnë dëshmitë mbi pajisjet

Si rezultat i këtyre dy kritereve OE "ER-LIS" është eliminuar nga konkurrenca dhe AK- Komuna Lipjanit për kontratë ka shpërblyer OE "Sinjali" me çmim te peshuar prej 147.00 Euro
Me të njëjtat arsyetime AK e ka refuzuar edhe kërkesën për rishqyrtim të parashtruar pranë AK-së

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Duke u bazuar ne kërkesat e dosjes se tenderit lidhur me kriteret kualifikues dhe vlerësuese Eksperti Shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit dhe shqyrtimit ofertave ka vlerësuar në përputhje me kriteret e përcaktuar për arsye se :

Tek kritere kualifikues aftësitë teknike dhe profesionale është kërkuar që OE t e ofrojnë dëshmi (kontrata dhe referenca) si ne vjim: *Një liste e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat kopje për kontratat e prezantuara pre projekte te ngjashme, Referencat duhet te jene ne 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate.*

Nëse i referimi listës kontratave që ka dorëzuar OE ankues dhe dëshmive te dorëzuara për referenca të realizuara kjo kërkesë nuk plotësohet nga OE ankues për faktin se një pjese e kontratave dhe referencave te realizuar i takon viteve 2016 dhe 2017 , pastaj një pjesë e tyre nuk janë kontrata të natyrës së shërbimeve të ngjashme por janë kontrate për rregullim te trotuareve kanalizimeve apo mirëmbajtje dimërore te rrugëve.

Gjithashtu edhe tek kërkesat pe makineri AK në njoftim për kontratë dhe ne dosje te tenderit ka kërkuar si në vijim: *Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet qe nuk regjistrohen, Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet qe regjistrohen, Librezat e qarkullimit me validitet*.

Sipas ofertës OE ankues ka ofruar një marrëveshje për marrje me qira te pajisjeve nga kompania "Ve-mor" , dhe një liste pajisjeve te hartuar nga vet ofertuesi qe liston pajisjet sipas kërkesave k të AK-së, por nuk ofron asnjë dëshmi pre posedim të e atyre pajisjeve siç janë faturat për blerjen e tyre , dudat doganor apo edhe ndonjë foto për pajisjet që posedon apo i ka në pronësi te vet.

Gjithashtu pretendimi për mos respektim të nenit 59 të LPP –së për vlerësim të ofertave nuk qëndron sepse vlerësimi është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuar për kualifikim dhe vlerësim.

Sipas kërkesave të dosje kriter vlershmi ka qenë çmimi me i ulet i poentuar dhe mbi baze e këtij kriteri ka vepruar edhe komisioni vlerësues respektivisht Autoritetit Kontraktues, pasi qe çmimi i poentuar i OE ankues ka qene 935.54 ndërsa çmimi i OE te rekomanduar 147.00 Euro

Kur AK vendos kriter vlershmi çmimi më i ulet i poentuar është domosdoshmëri qe AK që kontrate të rekomandoj OE i cili plotëson kriteret kualifikues dhe ofron çmim më t ë ulet të poentuar , dhe me ke rast konsiderojmë se çmimi i OE te rekomanduar në parim mund të konsiderohet i lire por kjo është ne diskrecion te AK te vlerësoj se çmimet me të cilat pretendohet të nënshkruhet kontrata janë te arsyeshme apo të nen vlerësuara pasi qe për këto shembim ka edhe periudhë garantuese.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues qe të mbet ne fuqi vendimi i AK-së dhe të vazhdohet me aktivitet të prokurimit pasi që oferta e OE ankues është e pa përgjegjshme bazua rn ë kriteret kualifikuese.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues,- Komuna e Lipjanit
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues: "ER-LISI" SHPK